

## Aneksi 5 – Kriteret e Kualifikimit dhe Pranueshmërisë

1. Emri dhe adresa e kompanisë / Numri i regjistrimit në Regjistrin Tregtar

2. Kompania është e regjistruar ligjërisht dhe e autorizuar për të ushtruar aktivitetin profesional të nevojshëm për realizimin e punës që është objekt i kësaj kërkesë për ofertë. Ju lutemi, paraqisni një ekstrakt nga QKB-ja.

3. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar nuk duhet të jetë më e vogël se 1,880,000 lekë.

4. Certifikatë/Konfirmim për pagesën e detyrimeve tatimore në përputhje me legjislacionin në fuqi;

5. Certifikatë/Konfirmim për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore në përputhje me legjislacionin në fuqi;

6 Certifikatë që konfirmon pagesën e të gjitha detyrimeve të energjisë elektrike të maturuara;

7. Numri i punonjësve – Ju lutemi paraqisni një dokument zyrtar që vërteton numrin e punonjësve për vitet e sipërpërmendura, duke dëshmuar se të paktën 1 (një) punonjës të përhershëm kanë qenë të regjistruar në secilin prej tre viteve të fundit (mesatarja për vitin 2023, mesatarja për vitin 2024 dhe mesatarja për vitin 2025). Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetsore në të cilin të jetë i percaktuar numri i punonjësve të siguruar për periudhën e mësipërme, shoqëruar me listepagesat perkatëse E-Sig, për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore.

8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme të realizuara gjatë tre (3) viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në fushën e dizajnit grafik, printimit dhe materialeve të komunikimit, me një vlerë totale jo më të vogël se 940,000 Lekë.

Titulli i projektit dhe klienti	Fusha/fokusi i detyrave	Rajoni	Periudha	Vlera e kontratës në LEK

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, kontraten midis paleve ku të shënohet preventivi dhe vlera dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Operatori për reference duhet të plotësojë dhe tabelën e mësipërme për kontratat e ngjashme.

9. Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) ekspert të kualifikuar në dizajn grafik, i cili plotëson kërkesat minimale të mëposhtme: eksperti duhet të zotërojë diplomë universitare ose kualifikim profesional përkatës në dizajn grafik, komunikim vizual ose në një fushë të ngjashme, si dhe të ketë të paktën tre (3) vite eksperiencë profesionale në dizajn grafik dhe zhvillimin e materialeve të komunikimit. Ekspertet duhet të dëshmojnë eksperiencë të provuar në dizajnimin e materialeve të printuara dhe/ose promovuese, si dhe në zhvillimin e koncepteve vizuale dhe layout-eve për fushata komunikimi ose ndërgjegjësimi.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë Curriculum Vitae (CV) të ekspertëve, kopje të diplomës, kualifikime përkatës, si dhe një portofol ose mostra të punëve të mëparshme. Operatori ekonomik duhet gjithashtu të paraqesë një deklaratë që konfirmon se eksperti i propozuar është jetë i disponueshëm dhe i angazhuar gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Gjithashtu, operatori ekonomik duhet të dëshmojë se eksperti i propozuar ka marrëdhënie ligjore me kompaninë, nëpërmjet kontratës së punës, kontratës së shërbimit, marrëveshjes së bashkëpunimit ose një forme tjetër të njohur ligjërisht të angazhimit, dhe duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës mbështetës.

#### 10. Dokumentacioni Teknik

- Përshkrimi i qasjes për dizajnin dhe prodhimin
- Mostra / katalogë (nëse disponohen)

#### 11. Deklaratë / Ofertuesi konfirmon:

- Kapacitetin për të ofruar shërbime dizajni dhe prodhimi
- Përputhshmërinë me specifikimet teknike
- Dorëzimin dhe transportin e materialeve
- Mbështetje të vazhdueshme gjatë zbatimit të kontratës

12. Emri i anëtarit kryesor të stafit përgjegjës për mbështetjen e projektit të mësipërm në selinë e kompanisë suaj;

#### 13. Personi i kontaktit për pyetje

emri:

email:

telefoni: